

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin shtator

2023

tetor 2023

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin shtator

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, tetor 2023

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

01. 02. 03. 04. 05. 06.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues, i pari i këtij lloji në Kosovë deri më tash, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit shtator 2023, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i pesëmbëdhjetë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma për kontroll të fakteve hibrid.info, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e informimit mediatik me ngjarjet për dhe rreth Kosovës. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të jep një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese




Ngjashëm si në muajt paraprakë korrik dhe gusht 2023, edhe gjatë këtij muaji (shtator 2023) kanë mbizotëruar artikujt me përmbajtje keqinformuese të vlerësuar si "clickbait" prej 31%. Ato pasohen nga përmbajtjet e paverifikuara në vendin e dytë me 25% dhe dezinformata në vendin e tretë me 18%.

Edhe gjatë muajve korrik-gusht 2023, publikimet keqinformuese në kategorinë "clickbait" ishin në vendin e parë po ashtu (29% në korrik 2023 dhe 33% në muajin gusht 2023). Megjithatë, dallimi kryesor qëndron tek dezinformatat që gjatë muajve paraprakë monitorues ishin radhitur në vendin e dytë (25% gjatë muajve korrik dhe gusht 2023), ndërsa këtë muaj monitorues kishin rënë në vendin e tretë, duke pësuar rënie prej 7% në krahasim me muajt paraprakë (ose 18% gjithsej dezinformata). Ndërkohë, gjetje tjetër me rëndësi janë keqinformimet e vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar, të cilat këtë muaj u renditën në vendin e dytë me 25% dhe patën rritjen më të madhe në raport me muajt korrik-gusht 2023 që gjatë atyre muajve figuronte në përqindje pothuajse të papërfillshme (6% në muajin korrik 2023 dhe 3% në muajin gusht 2023).

Kjo është ndër gjetjet kryesore të këtij raporti mujor monitorues sepse fokusi i mediave dhe publikuesve të ndryshëm ishte tek raportimi për çështje politike e të sigurisë përgjatë muajit shtator 2023 dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar. Për më tepër, ndër arsyet kryesore që kanë mbizotëruar përmbajtjet e paverifikuara para dezinformatave është se një përqindje e dukshme e keqinformimeve nga fusha e sigurisë në ndërlidhje me sulmin terrorist [1] ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit, më 24 shtator 2023, kanë marrë vlerësime si përmbajtje e paverifikuar.

Publikimet keqinformuese në këtë kategori vlerësimi për herë të fundit ishin renditur në vendin e dytë në muajin nëntor 2022, duke lënë mbrapa dezinformatat që pothuajse gjithmonë ishin në vendin e parë ose të dytë sipas matjeve të platformës “hibrid.info”.



31% e artikujve keqinformues kanë marrë vlerësimin “clickbait”.

[1] Sulmi ndaj [Policisë së Kosovës](#) u cilësua si sulm [terrorist](#) nga [Kosova](#) dhe [Bashkimi Evropian](#) dhe u dënua nga [Shtetet e Bashkuara të Amerikës](#).

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1.1

01. “Clickbait”

Pothuajse të gjitha përmbajtjet e vlerësuara si “clickbait” janë publikuar nga media reale në gjuhën shqipe. Pjesa dërrmuese e tyre janë publikuar në fushën e kronikës së zezë dhe atë sociale. Artikuj kryesorë të kronikës së zezë që kanë marrë vlerësime “clickbait” kanë trajtuar tema të ndryshme për vdekje, vrasje dhe aksidente. Në titujt e këtyre artikujve nuk bëhet e ditur për vendndodhjen e ngjarjes nën aludimin se ngjarja mund të ketë ndodhur në Kosovë, Shqipëri apo gjetiu ku ka audiencë në gjuhën shqipe për nxitjen e klikimeve duke lënë hapësirë për keqinformim. Ndërsa, keqinformimet në fushën sociale të vlerësuara si “clickbait” ishin rreth temës së rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore që nuk kishin të bënin me Kosovën, por kjo nuk bëhej e ditur në titujt e tyre.

03. Dezinformatë

Dezinformatat janë publikuar nga faqe në mediat sociale (Facebook) dhe portale të dyshimta në gjuhën shqipe, si dhe nga mediat në gjuhën serbe. Një përçindje e madhe e tyre janë publikuar në fushën e sigurisë, kurse pjesa tjetër janë nga politika, sporti dhe kuriozitetet. Të gjitha dezinformatat e publikuara nga publikues në mediat sociale ishin në gjuhën shqipe, kryesisht nga fusha e sigurisë lidhur me sulmin terrorist në Banjskë të Zveçanit dhe luftën në Ukrainë. Ndërkaq, artikujt keqinformues të mediave reale janë publikuar në gjuhën serbe lidhur me sulmin terrorist ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë. Përmes tyre pretendohet se misioni EULEX nuk është përfshirë në operacionet e Policisë së Kosovës në veri të Kosovës gjatë asaj dite, se ka pasur vrasës më pagesë në Policinë e Kosovës, se videoja ku shihet ish-nënkryetari i “Listës Serbe”, Milan Radojçiq nuk është e asaj dite, si dhe një audio-incizim me pretendimin se paraqet bisedën e pjesëtareve të Policisë së Kosovës me njërin nga sulmuesit e plagosur serb.

02. Përmbajtje e paverifikuar

Përmbajtjet e paverifikuara janë publikuar nga media reale dhe publikues në media sociale, si dhe pothuajse të gjitha prej tyre janë publikuar në gjuhën shqipe nga fusha e sigurisë, sportit dhe kronikës së zezë. Në këtë kategori vlerësimi kanë dominuar artikujt në fushën e sigurisë lidhur me zhvillimet në veriun e Kosovës që kanë trajtuar sulmin terrorist ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit gjatë muajit shtator 2023. Për këtë ngjarje, publikuesit kanë publikuar fotografi të paverifikuara me pretendimin se paraqesin sulmuesit e vrarë apo pjesëtarë të Policisë së Kosovës ose njësisë speciale të kësaj të fundit. Ndërsa, keqinformimet nga fusha e sportit përfshinin spekulime për futbollistët dhe Përfaqësuesen e Kosovës në futboll, kurse ato nga fusha e kronikës së zezë ndërlidhen me përmbajtjet në Libi dhe tërmetin në Marok.

04. Gabim

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese të vlerësuara si gabim janë publikuar nga media reale në gjuhën shqipe në fushën e sportit, kronikës së zezë dhe sociale. Në fushën e sportit, mediat raportuan gabimisht për çmimin e shitjes së fanellës së futbollistit të Kombëtares së Shqipërisë, Nedim Bajrami, si dhe u raportua gabimisht se Shqipëria ka fituar ndeshjen ndaj Çekisë të zhvilluar në Pragë në kualifikimet për Kampionatin Evropian 2024. Sa i përket tematikës sociale dhe kronikës së zezë, mediat gabimisht raportuan se është gjobitur një autobus i Trafikut Urban në Prishtinë dhe rasti i therjes me thikë të një vajze në Fushë Kosovë u raportua gabimisht se ka ndodhur në Obiliq.

05. Lajm i rremë

Lajmet e rreme janë publikuar nga publikues në media sociale, kryesisht nga faqe në gjuhën shqipe në Facebook. Në këto keqinformime u publikuan dhe shpërndan përmbajtje të rreme në fushën e sigurisë së Kosova do të furnizohet me pajisjet ushtarake turke “Boran 105mm”, ndërsa në fushën e sportit u pretendua rrejshëm se futbollisti shqiptar në Përfaqësuesen e Zvicrës, Granit Xhaka, të ketë thënë që nuk mund të shënoj ndaj Kosovës në ndeshjen me Zvicrën. Në kuadër të lajmeve të rreme u publikua edhe një imazh i edituar i tokës së sheshtë që paraqitet rrejshëm si fotografi e shkrepur nga misioni i Indisë në Hënë.

06. Teoritë konspirative

Teoritë konspirative u publikuan nga media reale dhe publikues në mediat sociale në gjuhën shqip dhe serbe. Artikujt me përmbajtje konspirative të mediave në gjuhën serbe u publikuan nga fusha e politikës, përfshirë pretendimin e shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë serbe, Petar Petković, se arrestimi i serbëve të dyshuar për krime të ndryshme ka për qëllim dëbimin e tyre nga Kosova. Artikujt keqinformues nga mediat reale në gjuhën shqipe me elemente konspirative ndërlidhen me njërin prej episodeve të serisë “The Simpsons” si paralajmërim për një luftë në Kosovë gjatë vjeshtës. Kurse, publikuesit në mediat sociale shpërndan parashikime konspirative nga konspiracionisti, Alfred Cako, përmes të cilave pretendohet se gjatë shtatorit 2023 pritet të ndodhë një luftë e madhe dhe se gjatë kësaj kohe do të hedhin helm gjarpri me avionë.


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: “Manipulim i fakteve”, “Mashttrim” dhe nga kombinim i kategorive “Dezinformatë / Përmbajtje e paverifikuar” dhe “Clickbait / Dezinformatë”.

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

2

KATEGORITË KRYESORE


Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Në bazë të monitorimit të përmbajtjeve keqinformuese, mediat dhe publikuesit e ndryshëm kanë publikuar më së shumti artikuj keqinformues për veriun e Kosovës prej 25% gjatë muajit shtator 2023. Arsyeja e aktualizimit të temës së veriut buron si pasojë e zhvillimeve në veri të Kosovës pas sulmit terrorist ndaj Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë të Zveçanit, në të cilën u vra një pjesëtar i Policisë së Kosovës dhe tre sulmues serbë. Pothuajse të gjitha publikimet keqinformuese lidhur me sulmin terrorist në Banjskë ishin nga fusha e sigurisë të publikuara kryesisht nga publikues në mediat sociale (Facebook) nga faqe në gjuhën shqipe që janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar dhe dezinformatë. Nga ana tjetër, përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe lidhur me këtë temë u publikuan në media reale dhe u vlerësuan si dezinformatë.

Kurse, artikujt keqinformues të koduar “raste tragjike” që trajtojnë raportimet e mediave për vdekje e vrasje të ndryshme është e dyta me 16%. Vlen të përmendet se kjo radhitet ndër temat kryesore gjatë muajve të fundit (korrik, gusht dhe shtator 2023) nga mediat reale në gjuhën shqipe, të cilat publikojnë artikuj nga kronika e zezë për raste të ndryshme tragjike pa e qartësuar në tituj vendin e ngjarjes. Për më tepër, kjo bëhet me synim të rritjes së klikimeve të artikujve që trajtojnë kronikën e zezë nën aludimin se ngjarja mund të ketë ndodhur në Kosovë, Shqipëri apo gjetiu ku ka audiencë në gjuhën shqipe për nxitjen e klikimeve.

Gjatë këtij muaji (shtator 2023) kishte përmbajtje keqinformuese për komunat me shumicë serbe në Kosovë (5%). Ato u publikuan nga mediat në gjuhën serbe për disa incidente që i interpretuan si tendencë për dëbimin e serbëve. Gjithashtu, portale të dyshimta dhe publikues në media sociale në gjuhën shqipe krijuan dhe shpërndanë keqinformime për disa ngjarje të pazakonshme, përfshirë imazhin e edituar të tokës së sheshtë, për hedhje helm gjarpri me avionë dhe shfaqjen e një krijese të pazakontë në Berat.



59% e temave kryesore janë për zhvillimet në veri, raste tragjike në rrethana të ndryshme, komunat me shumicë serbe, luftën në Ukrainë, ngjarje të pazakonta dhe tërmetin në Marok.

Analizë e kontroleve të fakteve sipas temave

2.1

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Veriu

Pothuajse të gjitha përmbajtjet keqinformuese lidhur me zhvillimet në veri janë publikuar në fushën e sigurisë dhe kanë trajtuar sulmin terrorist në Banjskë të Zveçanit dhe ngjarjet pasuese të këtij sulmi. Ato janë vlerësuar kryesisht si përmbajtje e paverifikuar dhe dezinformate, të publikuara në media reale dhe faqe në mediat sociale në gjuhën shqipe e serbe. Temat e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe ndërlidheshin me fotografi dhe video-materiale të ndryshme, nëpërmjet të cilave pretendohet se paraqesin pjesëtarë të njësisë speciale të Policisë së Kosovës, sulmuesit serbë të vrarë, pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe pamje të varrimit të sulmuesve serbë të vrarë. Ndërkaq, artikujt dezinformuese në gjuhën serbe u publikuan nga media reale me pretendimet e rreme të zyrtarëve serbë për mospërfshirjen e EULEX-it në operacionet e Policisë së Kosovës, se brenda Policisë së Kosovës kishte vrasës me pagesë, si dhe pretendimit të rremë se video-materiali i publikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës brenda oborrit të Manastirit në Banjskë, në të cilin shihet tashmë ish-nënkryetari i “Listës Serbe”, Milan Radojçiq, nuk i përkiste ditës së sulmit (Radojçiq kishte dhënë dorëheqje nga ky funksion disa ditë pas sulmit në Banjskë).

02. Raste tragjike (vdekje, vrasje)

Shumica dërrmuese e artikujve keqinformues për raste tragjike janë publikuar në fushën e kronikës së zezë dhe janë kategorizuar si “clickbait”, të cilat janë publikuar nga media reale në gjuhën shqipe. Artikujt në kuadër të kësaj temë të keqinformimit kanë trajtuar vdekje e vrasje në rrethana të ndryshme dhe për të cilat nuk bëhet e ditur në titujt e tyre vendi i ngjarjes me synim për të nxitur klikime nga lexuesit.

04. Lufta në Ukrainë

01.Keqinformatat lidhur me luftën në Ukrainë u publikuan në media reale dhe faqe të ndryshme në Facebook në gjuhën shqipe. Ato janë vlerësuar si dezinformate dhe përmbajtje e paverifikuar të trajtuara në fushën e sigurisë dhe politikës. Ato ndërlidhen me dezinformatën se rekrutimi i ukrainasve në ushtri po ndodh dhunshëm dhe përmbajtjen e paverifikuar se New York është shfaqur një afishe me titullin “Lavdi urinës” në vend të “Lavdi Ukrainës”.


03. Komunat me shumicë serbe

Përmbajtjet keqinformuese për këtë temë janë publikuar kryesisht në fushën e politikës dhe sigurisë, të cilat kanë marrë vlerësime dezinformate, teori konspirative dhe përmbajtje e paverifikuar. Raportimet keqinformuese për komunat me shumicë serbe janë publikuar nga media në gjuhën serbe, duke dezinformuar se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vënë nën shënjestër fëmijët serbë, duke ngritur teori konspirative se arrestimi i serbëve nën dyshimin për krime lufte në Kosovë ka për qëllim dëbimin e tyre nga Kosova, si dhe përmbajtje e paverifikuar se mbishkrimi “UÇK”, në një shkollë në Kllokot, paraqet urrejtje ndaj serbëve.

Llojet e fushave

Në bazë të të dhënave monitoruese për muajin shtator 2023, fusha e sigurisë ka mbizotëruar dukshëm mbi të gjitha temat dhe fushat tjera gjatë këtij muaji nga raportimet keqinformuese të publikuesve (media, portale të dyshimta dhe publikuesit në mediat sociale) në gjuhën shqipe e serbe. Kjo është hera e parë që nga muaji dhjetor 2022 kur fusha e sigurisë është në vendin e parë me 33% sa i përket keqinformimit dhe atë në ndërlidhje me zhvillimet në veri të vendit. Në këtë drejtim, sulmi terrorist në veriun e Kosovës, më 24 shtator 2023, ka ndikuar që keqinformimet në fushën e sigurisë dhe veçanërisht për këtë temë të jenë në fokus të mediave dhe publikuesve të monitoruar nga “hibrid.info”. Temat tjera të trajtuar në aspektin e sigurisë janë edhe përmbajtjet keqinformuese për armatosjen e FSK-së, paralajmërim për një luftë në Kosovë gjatë vjeshtës, zhvillime në komunat me shumicë serbe dhe spekulime për luftën në Ukrainë.

FUSHAT KRYESORE
Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Mbizotërimi i artikujve keqinformues në fushën e sigurisë është prej gjetjeve kryesore të këtij raporti në krahasim me muajt paraprak monitorues. Për shembull, në muajin gusht 2023, kishte mbizotëruar dukshëm fusha e politikës në vendin e parë, e cila shënoi rënie drastike prej 25% këtë muaj duke u renditur e katërta për nga numri i publikimeve (nga 37% gjatë muajit gusht 2023, në 12% gjatë muajit shtator 2023). Në anën tjetër, fusha e sigurisë ka shënuar rritje të konsiderueshme prej 24% këtë muaj në krahasim me muajin paraprak (nga 9% në muajin gusht 2023, në 33% në muajin shtator 2023), duke u radhitur e para si fushë e keqinformimit. Siguria pasohet nga kronika e zezë me 27%, e cila ka pasur një rritje të lehtë prej 3% krahasuar me muajin paraprak (gusht 2023). Fusha e sigurisë dhe e kronikës së zezë përbëjnë më shumë se gjysmën e përmbajtjeve keqinformuese për këtë muaj (rreth 60%), edhe pse këto dy fusha nuk ndërlidhen me njëra tjetrën. Një përqindje e konsiderueshme e artikujve keqinformues nga fusha e sigurisë janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar dhe dezinformatë, kurse të gjitha përmbajtjet keqinformuese nga kronika e zezë janë vlerësuar si “clickbait”.

Karakteristikë tjetër e këtij muaji është rënia e dukshme prej 13% e publikimeve keqinformuese për çështje sociale (nga 22% në muajin gusht 2023, në 9% gjatë muajin shtator 2023). Ndërkaq, ka rritje të ndjeshme të artikujve në fushën e sportit (16%), si pasojë e përmbajtjeve keqinformuese në ndërlidhje me Përfaqësuesen e Kosovës dhe atë të Shqipërisë në futboll për ndeshjet kualifikuese, të vlefshme për Kampionatin Evropianin 2024.

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese nga fusha e sigurisë janë publikuar nga faqe në mediat sociale (Facebook) në gjuhën shqipe me 19% dhe në media reale me 14% (në gjuhën shqipe dhe serbe). Sa i përket kategorive vlerësuese të keqinformimit, 14% prej tyre janë vlerësuar si dezinformata, 9% përmbajtje e paverifikuar dhe 3% manipulim i fakteve. Dezinformatat kryesisht janë publikuar nga media në gjuhën serbe dhe faqe në mediat sociale në gjuhën shqipe lidhur me sulmin terrorist ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit. Ndërsa, përmbajtjet e paverifikuara (kryesisht fotografi) janë publikuar nga faqe në Facebook në gjuhën shqipe me pretendimin se paraqesin ngjarjet në Banjskë.

Artikujt keqinformues me tematikën e kronikës së zezë kanë marrë më së shumti vlerësime “clickbait” (19%), pasuar nga përmbajtje të paverifikuara (6%) dhe gabim (2%). Pothuajse të gjitha përmbajtjet “clickbait” janë publikuar nga media në gjuhën shqipe lidhur me vdekje dhe vrasje në rrethana të ndryshme.

Ndërkaq, përmbajtjet keqinformuese në fushën e sportit janë publikuar nga media dhe faqe në mediat sociale në gjuhën shqipe, të cilat janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar (6%), “clickbait” (3%) dhe gabim (3%). Edhe publikimet në fushën e politikës kryesisht janë publikuar nga media në gjuhën serbe dhe faqe në mediat sociale në gjuhën shqipe, të cilat kanë marrë vlerësime të përmbajtjes së paverifikuar (3%), “clickbait” (3%) dhe teorisë konspirative (2%).



97% e përmbajtjeve keqinformuese janë për sigurinë, kronikën e zezë, sportin, politikën dhe çështjet sociale.

Llojet e publikuesve



4

Ngjashëm si në muajin paraprak (gusht 2023), edhe gjatë muajit shtator 2023, numri më i madh i artikujve keqinformues janë publikuar nga mediat reale prej 59%. Madje, ka rritje prej 8% krahasuar me muajin paraprak (nga 51% në gusht 2023, në 59% në shtator 2023). Kjo mund të shpjegohet nga fakti se të gjitha keqinformatat e vlerësuara “clickbait” dhe gabim, si dhe një numër i konsiderueshëm i dezinformatave dhe përmbajtjeve të paverifikuara janë publikuar në media reale (në gjuhën shqipe dhe serbe).

Nga ana tjetër, 39% e artikujve për këtë muaj janë publikuar dhe shpërndarë nga publikues në mediat sociale në gjuhën shqipe në të cilat kanë dominuar përmbajtjet e paverifikuara, dezinformatat dhe lajmet e rreme. Ndërsa, vetëm 2% janë publikuar nga portale të dyshimta.

Siç shihet, në krahasim me muajin gusht 2023, publikimet keqinformuese në mediat reale, gjatë muajit shtator 2023, kanë shënuar një rritje, ato në mediat sociale janë pothuajse të njëjta, ndërsa në portale të dyshimta vërehet rënie prej 7%.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




98% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga media (59%) dhe publikuesit në mediat sociale (39%).

5

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE TË MEDIAVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Edhe gjatë këtij muaji, publikuesit e ndryshëm në gjuhën shqipe kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese prej 89%. Kjo është e kuptueshme marrë parasysh se mostra e monitorimit nga platforma “hibrid.info” fokusohet më tepër tek përmbajtjet e publikuara në gjuhën shqipe nga mediat reale, publikuesit në mediat sociale dhe portalet e dyshimta, ndërsa në gjuhën serbe monitorohen kryesisht vetëm raportimet keqinformuese të mediat reale serbe lidhur me zhvillimet për dhe rreth Kosovës.

Bazuar në të dhënat e monitorimit, 48% e artikujve keqinformues në gjuhën shqipe janë publikuar në media reale, 39% nga publikues në mediat sociale dhe 2% në portale të dyshimta. Ndërsa, të gjitha keqinformatat në gjuhën serbe janë publikuar në media reale (11%) lidhur me ngjarjet në veri të Kosovës duke trajtuar sulmin terrorist në Banjskë të Zveçanit.

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe dhe serbe. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet në gjuhën shqipe


Përmbajtjet e vlerësuara “clickbait” vazhdojnë të mbizotërojnë edhe gjatë këtij muaji tek publikimet e mediave në gjuhën shqipe sepse të gjitha përmbajtjet nga kronika e zezë dhe një përqindje relativisht e vogël nga politika, sporti dhe çështje sociale janë vlerësuar në këtë kategori. “Clickbait” pasohet nga përmbajtjet e paverifikuara dhe dezinformatat kryesisht nga fusha e sigurisë lidhur me zhvillimet në veri në ndërlidhje me sulmin terrorist ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit. Të dhënat e monitorimit të tregojnë se mbi gjysma e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe i përkasin fushës së sigurisë dhe kronikës së zezë. Përderisa në fushën e sigurisë kanë mbizotëruar temat lidhur me zhvillimet në veri, temat nga kronika e zezë kanë trajtuar raste tragjike (vdekje dhe vrasje të dyshimta).

02. Publikimet në gjuhën serbe

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe janë publikuar nga mediat reale që kanë trajtuar tema të sigurisë dhe politikës në lidhje me ngjarjet në Kosovë gjatë muajit shtator 2023. Publikimet e mediave në gjuhën serbe janë vlerësuar dezinformata, përmbajtje e paverifikuara dhe teori konspirative. Dezinformatat e shpërndara nga këto media ngritin pretendime të pavërteta të zyrtarëve serbë lidhur me sulmin terrorist në Banjskë, se video-materiali i publikuar nga institucionet e Kosovës, në të cilin shihet Milan Radojçiq, nuk ishte i asaj dite kur ndodhi sulmi, se nuk është lejuar EULEX-i të marrë pjesë në operacionet e Policisë së Kosovës dhe se në radhët e kësaj të fundit kishte vrasës me pagesë. Publikimet e mediave në gjuhën serbe përmbajnë edhe interpretime konspirative për arrestim të serbëve nën dyshimin për krime lufte të kryera në Kosovë me qëllim të dëbimit të tyre nga Kosova dhe përmbajtje të paverifikuara se mbishkrimi “UÇK”, në një shkollë në Kllokot, paraqet urrejtje ndaj serbëve.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.




Institucioni më i përfolur gjatë këtij muaji është Policia e Kosovës, e cila kthehet në krye të listës së institucioneve më të përfolura nga media dhe publikues të ndryshëm prej 51%. Policia ka mbizotëruar këtë muaj për shkak të situatës së sigurisë në veriun e Kosovës dhe veçanërisht gjatë dhe pas sulmit terrorist në Banjskë të Zveçanit, në fund të muajit shtator 2023.

Policia e Kosovës, si institucion i sigurisë, u përfol në dezinformatat e publikuara nga mediat në gjuhën serbe lidhur me sulmin terrorist në Banjskë, duke pretenduar se kishte vrasës me pagesë në radhët e Policisë së Kosovës, se misioni EULEX nuk ishte lejuar të marrë pjesë në operacionin e udhëhequr nga Policia, se ishin vënë në shënjestër fëmijët serbë etj. Krahas tyre, Policia u përfol edhe në dezinformatat dhe përmbajtjet e paverifikuara të shpërndara nga faqe në gjuhën shqipe ,në mediat sociale (Facebook), lidhur me sulmin terrorist në Banjskë.

Institucione ose organizata tjera të përfolura janë Forca e Sigurisë së Kosovës, Trafiku Urban, KFOR-i, Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe, organizata serbe “Brigada e Veriut” (e cila është shpallur organizatë terroriste nga Qeveria e Kosovës në qershor 2023), Ministria e Brendshme e Serbisë dhe seria “The Simpsons”.

Përveç Policisë së Kosovës, të gjitha institucionet tjera të përmendura, në tabelën e mësipërme, janë përfolur një herë në përmbajtjet keqinformuese të publikuara nga publikues të ndryshëm gjatë muajit shtator 2023.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Sa i përket personaliteteve më të përfolura në keqinformimet e publikuara këtë muaj, drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë serbe, Petar Petkoviç, në kontekst edhe me personalitete tjera, është figura më e përfolur. Arsyeja pse Petkoviç është më i përfoluri gjatë muajit shtator 2023 ndërlihet me deklaratimet e tij të shpeshta, përmes të cilave shpërndante dezinformata rreth sulmit terrorist në Banjskë të Zveçanit. Mediat në gjuhën serbe përfolën pretendimet dezinformuese të Petkoviçit lidhur me sulmin terrorist në Banjskë për mospërfshirjen e EULEX-it dhe dezinformatat tjetër se në mesin e Policisë së Kosovës kishte vrasës me pagesë.

Edhe pse kryesonte në raportet mujore gjatë gjithë këtij viti (janar-gusht 2023), por edhe në raportet monitoruese të vitit të kaluar (korrik-dhjetor 2022), kryeministri i Kosovës, Albin Kurti është radhitur i dyti nga personalitetet e përfolura në keqinformatat e publikuara gjatë muajit shtator 2023. Ai u përfol në dezinformatat e mediave në gjuhën serbe lidhur me pretendimin se pas sulmit terrorist në Banjskë, Kurti ka vënë nën shënjestër fëmijët serb. Gjithashtu, kryeministri Kurti u përfol nga mediat shqipe në pretendimet e tyre se është kërcënuar me jetë (edhe pse jo shprehimisht) nga organizata “Brigada e Veriut” në veri, e cila është shpallur terroriste nga Qeveria e Kosovës.

Personalitetet tjera të përfolura janë futbollistët shqiptarë Altin Zeqiri, Vedat Muriqi, Nedim Bajrami, Granit Xhaka dhe trajnerët e futbollit Fatih Terim dhe Maurizio Pochettino, si dhe personalitete të tjera publike.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në bazë të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjitha artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore dhe atë në formë kryesisht kuantitative për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese njëmuajore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar – IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 30 shtator 2023.

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit shtator 2023, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Gjatë muajit shtator 2023, mediat dhe publikuesit e ndryshëm kanë krijuar dhe shpërndarë më së shumti artikuj “clickbait” me 31%, pasuar nga përmbajtjet e paverifikuara me 25% dhe dezinformata me 18%. Pjesa dërrmuese e artikujve “clickbait” janë publikuar nga mediat në gjuhën shqipe, kryesisht nga fusha e kronikës së zezë (19%). Përmbajtjet e paverifikuara janë publikuar nga faqe në mediat sociale (16%) dhe media reale (9%) nga fusha e sigurisë, sportit, kronikës së zezë dhe politikës. Pothuajse të gjitha dezinformatat janë publikuar në fushën e sigurisë nga faqe në mediat sociale (9%) në gjuhën shqipe dhe media reale në gjuhën serbe (8%).

Sa i përket temave, sulmi terrorist ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë e ka kthyer veriun e Kosovës si temën kryesore të keqinformimit gjatë muajit shtator 2023 prej 25%. Pothuajse të gjitha publikimet keqinformuese lidhur me sulmin terrorist në Banjskë ishin nga fusha e sigurisë, kryesisht të publikuara nga faqe në mediat sociale (Facebook) në gjuhën shqipe të vlerësuara si përmbajtje e paverifikuar dhe dezinformate. Kurse, përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe lidhur me këtë temë, u publikuan në media reale dhe u vlerësuan si dezinformate. Artikujt keqinformues për temën e vdekjeve dhe vrasje të koduara si “raste tragjike” janë radhitur si tema e dytë më e trajtuar me 16% për të cilat nuk bëhet e ditur në titujt e artikujve vendndodhja e ngjarjeve. Këta artikuj keqinformues janë publikuar nga media në gjuhën shqipe.

Siguria dhe kronika e zezë janë dy fushat që nuk ndërliqhen njëra me tjetrën, por që të dyja përbëjnë më shumë se gjysmën e përmbajtjeve keqinformuese (rreth 60%) për muajin shtator 2023. Shumica e përmbajtjeve nga fusha e sigurisë u vlerësuan si dezinformate dhe përmbajtje e paverifikuar të cilat u publikuan nga faqe në gjuhën shqipe në mediat sociale (Facebook), si dhe mediat reale në gjuhën serbe. Ndërsa, përmbajtjet keqinformuese nga kronika e zezë në vendin e dytë me 27% u publikuan kryesisht nga mediat në gjuhën shqipe dhe shumica prej tyre u vlerësuan “clickbait”. Fushat tjera të keqinformimit përfshijnë sportin (16%) dhe politikën (12%).

Edhe në këtë muaj (shtator 2023), publikimet keqinformuese në mediat reale prijnë me 59%, duke u pasuar nga mediat sociale (Facebook) me 39% dhe portalet e dyshimta me 2%. Në bazë të monitorimit për muajin shtator, 89% e përmbajtjeve keqinformuese janë publikuar nga media dhe faqe në mediat sociale (Facebook) në gjuhën shqipe, ndërsa 11% në mediat në gjuhën serbe. Derisa gjysma e përmbajtjeve keqinformuese të publikuara në gjuhën shqipe janë nga fusha e sigurisë dhe kronikës së zezë, të gjitha përmbajtjet në gjuhën serbe janë nga fusha e sigurisë dhe politikës. Mediat dhe publikuesit në gjuhën shqipe, gjatë këtij muaji, kanë publikuar më së shumti artikuj “clickbait” me 31% për raste tragjike, ndërsa përmbajtjet e paverifikuara zënë vendin e dytë me 23%, pasuar nga dezinformata në vendin e tretë me 11%. Ndërsa përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe janë vlerësuar si dezinformata (8%), pasuar nga përmbajtje e paverifikuar (2%) dhe teori konspirative (2%) lidhur me sulmin terrorist në Banjskë në shtator 2023.

Institucioni më i përfolur është Policia e Kosovës (PK) nga media dhe publikues në gjuhën shqipe dhe serbe lidhur me sulmin terrorist në Banjskë,. Ndërkaq, sa i përket personaliteteve, drejtori i Zyrës për Ksoovën në Qeverinë serbe, Petar Petković, , është më i përfoluri në kontekst me personalitet tjera dhe ndërlidhur me sulmin terrorist në Banjskë. Në krahasim me muajt paraprakë monitorues, gjatë muajit shtator 2023, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, radhitet i dyti në raportimet keqinformuese të mediave dhe publikuesve të ndryshëm që janë monitoruar nga platforma “hibrid.info.

HIBRIDO.INFO